

PLAN-PROGRAMI I PUNËS NË GJUHËN SHQIPE

QËLLIMI

Programi ka për qëllim që fëmijët shqiptar të mësojnë, të zotërojnë dhe ta kultivojnë gjuhën dhe letërsinë shqipe, historinë, artin, kulturën dhe traditën shqiptare, të nxiten dhe të motivohen për të mbajtur kontakte të përhershme me vendlindjen dhe me atdheun e tyre.

DETYRAT E PUNËS EDUKATIVO – ARSIMORE

Programi i punës ka këto detyra kryesore:

- që nxënësit shqiptarë të ruajnë, të mësojnë dhe të kultivojnë gjuhën shqipe dhe të aftësohen për shkrim-lexim.
- që nxënësit të aftësohen për aplikimin e të gjitha formave të komunikimit me gojë dhe me shkrim.
- që të nxënësit të shtohet interesimi për leximin e veprave letrare të krijuesve shqiptarë dhe të letërsisë botërore.
- që të njihen me atdheun, gjeografinë e tij, historinë e tyre, përparimin e popullit shqiptarë dhe të civilizimit bashkëkohor.
- që të nxitet, të zhvillohet dhe të kultivohet kreativiteti i lirë i nxënësve në fushat e artit, letërsisë, muzikës, filmit dhe formave tjera të shprehjes dhe krijimit artistik.
- që të nxënësit të zhvillohet dashuria, respekti, kujdesi, mirëkuptimi dhe solidariteti i ndërsjellët ndërmjet nxënësve, nxënësve dhe arsimtarit, arsimtarit dhe prindërve dhe midis njerëzve ku jetojnë.
- kultivimin e ndjenjave miqësore ndaj të gjithë popujve të botës në parimin e barazisë dhe të mirëkuptimit të ndërsjellë.
- T'u mundesojë nxënësve ta zhvillojnë shumëgjuhësinë dhe interkulturalitetin si mënyra të jetesës në shoqërinë bashkëkohore.

KLASA	PËRMBAJTJA	LITERATURA DHE BURIMET
Parashkollore	<ul style="list-style-type: none">- ngjyrat- numrat 1-10- format, trekëndëshi, katrori, rrethi- unë, familja ime, shokët dhe shoqet (një shoqe ose shok i mirë)- shkolla ime- trupi im- pemët dhe perimet- kafshët insektet- këngë të ndryshme për fëmijë- përralla të ilustruara- ditët e javës, stinët e vitit- stinët e vitit- viti i ri, bredhi, babadimri, dhuratat- festat- vjersha për fëmijë- semafori- shqiptimi i tingujve në gjuhën shqipe- fjalë të kundërta- di për ujin, ajrin, tokën	<p><i>Përralla të ilustruara</i> <i>Kësulëkuqja</i> <i>Hirushja</i> <i>Maçoku me çizme</i> <i>Rosaku i shëmtuar</i></p>

KLASA	PËRMBAJTJA	LITERATURA DHE BURIMET
1	<ul style="list-style-type: none"> - ushtrime të të shprehurit me gojë - alfabeti i gjuhës shqipe - zanoret dhe bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe - tingujt karakteristik të gjuhës shqipe (krahasimi me ato të suedishtes) - shqiptimi i drejtë i fjalëve dhe i tingujve të veçantë të gjuhës shqipe - pika, përdorimi i shkronjës së madhe - ditët e javës - natyra, stinët e vitit - numrat, 0-20 - katrori, trekëndëshi, rrethi 	<p style="text-align: center;"><i>Abetarja Plotësori i abetares Përralla të ilustruara Hirushja Kësulëkuqja Borëbardha</i></p>
2	<ul style="list-style-type: none"> - fjalia - shenjat e pikësimit - emri dhe gjinia e emrit - drejtshqiptimi i tingujve : q, ç, gj, xh, z, rr, i, y, o, u, ë - përshkrimi me gojë dhe me shkrim i vendlindjes në bazë të kujtimeve - këndimi i këngëve popullore të vendlindjes - kafshët shtëpiake - si matet koha - atdheu im - muajt e vitit - kafshët shtëpiake - pranvera – natyra në pranverë 	<p style="text-align: center;"><i>Abetarja Pas abetares Tre lepurushët Hansi dhe Greta Vallja e shkronjave</i></p>
3	<ul style="list-style-type: none"> - fjalia e thjeshtë dhe e zgjeruar - emri i përveçëm dhe i përgjithshëm, gjinia e emrit - folja - festat kombëtare dhe fetare - orientimi në hartën gjeografike të viseve shqiptare - ushtrime me gojë dhe me shkrim kushtuar nënës - dëgjimi dhe këndimi i këngëve për fëmijë - mirësjellja në shkollë, rrugë, shoqëri - bimët, pemët dhe perimet - instrumentet muzikore - tekste të ndryshme me tregime - shikim i filmave për fëmijë 	<p style="text-align: center;"><i>Libër leximi "Zemra ime" fletore pune Bedri Dedja "Përralla për kafshët" Filmi: "Ujku dhe kecat"</i></p>

KLASA	PËRMBAJTJA	LITERATURA DHE BURIMET
4	<ul style="list-style-type: none"> - emri (zgjerim njohurish) - parafjalët: më, për, pa, nga, prej, në, mbi etj. - mbiemri - përemri, përemri vetor, përemri pronor - folja (zgjerim njohurish) - përshkrim i peizazheve në rrugë për në atdhe - përshkrim i vendbanimeve dhe peizazheve të Suedisë - hartime kushtuar nënës - profesionet - dëgjim i këngëve popullore nga atdheu - gjuha standarde - traditat, gjuha dhe veshja e popullit dhe krahasimi me atë suedeze 	<p style="text-align: center;"><i>Leximi 3/4 , Fletore pune 3/4 Libër leximi: "Zemra ime" Përrallat më të bukura shqiptare Pipi Çorapegjata Astrid Lindgren</i></p>
5	<ul style="list-style-type: none"> - pjesët e ndryshueshme të ligjëratës(emri, mbiemri, përemri, folja) - fjalia, zgjerim njohurish - shenjat e pikësimit - numërori - vendlindja e prindërve dhe e fëmijëve, përshkrimi i vendlindjes dhe i vendeve të tjera që kanë vizituar fëmijët - simbolet kombëtare dhe shtetërore, vizatimi i tyre - bukuritë natyrore të vendlindjes - zakonet popullore dhe folklori nga atdheu - shikimi dhe komentimi i filmave shqiptarë ku protagonist kryesor janë fëmijët - letërkëmbim me farefisën dhe shokët në atdhe - tregime të ndryshme për Skënderbeun dhe luftërat e tij - përkthime tekstesh nga suedishtja dhe anasjelltas - IT- kërkim i fakteve dhe burimeve tjera nga atdheu - qyteti im i banimit – Landskrona 	<p style="text-align: center;"><i>Leximi 3/4 Fletore pune 3/4 Libër leximi: "Shkollë e jetë" "Rozafati" – Mitrush Kuteli "Verorja" – Rexhep Hoxha</i></p>
6	<ul style="list-style-type: none"> - emri (zgjerim njohurish) - mbiemri - përshtatja e mbiemrit me emrin - numërori (zgjerim njohurish) - llojet e fjalive - shkrimi i nyjeve të përparme (të,së) - ilirët - vikingët- Paraardhësit e suedezeve - pozita gjeografike viseve shqiptare në Ballkan - kompozitorët e njohur shqiptarë -dhe veprat e tyre - monumente historike të atdheut tim - himni i flamurit kombëtar - IT- interneti -burime të ndryshme - përkthimi i teksteve nga suedishtja në shqip dhe anasjelltas - tekste të ndryshme letrare 	<p style="text-align: center;"><i>Shkollë e jetë Fakte mbi historinë dhe gjeografinë Leximi i gjashtë "Lushi si askushi"- Arif Demolli</i></p>

KLASA	PËRMBAJTJA	LITERATURA DHE BURIMET
7	<ul style="list-style-type: none"> - përemrat -thëllimi i njohurive - folja-thëllimi i njohurive - shpallja e pavarësisë së shtetit shqiptar - personalitete të rëndësishme historike deri në luftën e dytë – botërore - shqiptarët në luftën e dytë botërore - artist dhe kompozitor të njohur shqiptarë - Tema: Pozita gjeografike e trojeve shqiptare në Ballkan (malet fushat,lumenjtë,qytetet etj)-krahasimi i tyre me ato të Suedisë - Gustav Vasa - përkthime tekste të ndryshme nga suedishtja në shqip dhe anasjelltas - Selma Lagerlöf - IT- burime të ndryshme nga interneti - tekstet të ndryshme 	<p style="text-align: center;"><i>Shkollë e jetë Fakte mbi historinë dhe gjeografinë Gjuha shqipe Leximi letrar Histori e gjeografi</i></p>
8	<ul style="list-style-type: none"> - fjalia (zgjerim njohurish) - llojet e fjalive (dëftore, pyetëse, thirrrore, dëshirore) - fjalia mungesore (e pa plotë) - ushtrimi i intonacionit dhe theksit - tekste të ndryshme letrare - rëndësia e ruajtjes së gjuhës amtare dhe e mbajtjes së kontakteve me atdheun - shqyrtimi i ngjarjeve të rëndësishme të ne dhe në botë - përkthimi i teksteve të ndryshme - referat me shkrim - shqiptarët mes dy luftërave botërore - figurat dhe datat e rëndësishme historike prej LDB deri më sot - relievi, klima, uji dhe bota bimore e shtazore e viseve shqiptare - artistët tanë të njohur - personalitete të shquara shqiptare (Skënderbeu, Nënë Tereza, Aleksandër Moisiu, Ismail Kadare, Xhim Belushi etj.) - tema “Nënë Tereza” - Alfred Nobel - shkrimet e para shqipe - shkrimtarët e vjetër shqiptarë - IT 	<p style="text-align: center;"><i>Gjuha shqipe Antologjia Lexim letrar Revista të ndryshme</i></p>
9	<ul style="list-style-type: none"> - emri, mbiemri, përemri, folja, numërori (zgjerim njohurish) - dialektet e gjuhës shqipe (zgjerim njohurish) - punime të pavarura letrare të nxënësve me tematika të ndryshme - Gjergj Kastrioti – Skënderbeu (zgjerim njohurish) - shqyrtim i ngjarjeve të ndryshme të ne dhe në botë - bisedë për punën dhe për jetën e njerëzve në vendin nikoqir dhe në vendet e tyre të punës - në bashkëpunim me shkollën suedeze, paraqitja e këngëve dhe valleve tona popullore nga nxënësit tanë në shkollë - nobelistët shqiptarë, Nënë Tereza, Ferid Murati 	<p style="text-align: center;"><i>Antologjia Lexim letrar Histori Fan Noli “Album” Revista të ndryshme</i></p>

	<ul style="list-style-type: none">- data të shënuara ë historinë e popullit shqiptar- shkrimtarët e njohur shqiptar- leximi i literaturës artistike për të rinj- punë e pavarur, mbledhje e të dhënave për atdheun dhe Suedinë- tema “Komuna ime në vendlindje”- tekste të ndryshme letrare- IT	
--	---	--